





**Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës**  
Republika Kosova- Opstine Suvareka  
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka




*Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim*

|                       |                                                                      |
|-----------------------|----------------------------------------------------------------------|
| <b>Nr-DATË/A:</b>     | 07Nr.341/350-40862 datë: 08.09.2020                                  |
| <b>REFERENC-Ë:</b>    | 07Nr.350-40862 datë: 01.09.2020                                      |
| <b>PËR/TO:</b>        | <b>Agro-Rural Consultancy Group ShPK me përfaqësues Bexhet Basha</b> |
| <b>KOPJE/COPY:</b>    | Drejtorinë e Inspeksionit,<br>Dosje të Drejtorisë                    |
| <b>NGA/FROM:</b>      | Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim                               |
|                       | DREJTORI: Sanie KUQI<br>Zyrtar: Elona BUQA, BA                       |
| <b>LËNDA/SUBJECT:</b> | Aktvendim mbi Leje Ndërtimore                                        |



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350-40862 datë: 01.09.2020 nga Agro-Rural Consultancy Group ShPK me përfaqësues Bexhet Basha nga fshati Vraniq, Komuna Suharekë, për Leje Ndërtimore për objektin depo për ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve, me etazhitet P+0, në parcelën kadastrale 00014-0, me numër referues të certifikatës 3092-2020 datë 20.08.2020, pronë e Bexhet Basha, andaj pas shqyrtimit të kërkesës ky organ vendos, si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj shkrese.

- AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE**



**Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim**

**Data: 08.09.2020**

**Numri i vrojtimit i lejes:**

**07Nr.341/350-40862**

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, nenit 17 të Udhëzimit Administrativ 06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031, Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve 01-Nr-16-423, datë 26.01.2011, Rregullore për tarifa nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale 01Nr-16-9367, datë 31.12.2014; neni 2, pika 2.1 dhe 2.2 si dhe sipas Planit Zhvillimor Komunal 01Nr.5821 datë 05.03.2008, kërkesës dhe dokumenteve të paraqitura nga Bexhet Basha - Vraniq, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim lëshon këtë:

**AKTVENDIM  
(MBI LEJE NDËRTIMORE)**

**Kjo leje ndërtimore i lëshohet:**

|         |                                                                           |               |                                                                 |
|---------|---------------------------------------------------------------------------|---------------|-----------------------------------------------------------------|
| Emri:   | <b>Agro-Rural Consultancy Group</b><br>me përfaqësues <b>Bexhet Basha</b> | Nr. Personal  |                                                                 |
| Adresa: | <b>Rr." Rizah Kadolli", Vraniq</b>                                        | Telefoni:     |                                                                 |
| Email : |                                                                           | Kërkesa Bazë: | Aplikim për leje ndërtimore:<br>07Nr.350-40862 datë: 01.09.2020 |

|                                                                                                       |                                                        |                                                                         |                                                                    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------|
| Emri i Projektit:                                                                                     | Depo për ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve |                                                                         |                                                                    |
| Emri i Projektuesit:                                                                                  | "Pika Design ShPK", Prizren                            |                                                                         |                                                                    |
| Adresa:                                                                                               | Rr."Sheh Emini" PN, Prizren                            |                                                                         |                                                                    |
| Telefoni:                                                                                             |                                                        | Emaili:                                                                 |                                                                    |
| Për punët ndërtimore në vijim: <b>NDËRTIM I RI (i përkohshëm)</b>                                     |                                                        |                                                                         |                                                                    |
| Adresa: Rr." Rizah Kadolli", Vraniq - Suharekë                                                        |                                                        |                                                                         |                                                                    |
| Zona(t) Kadastrale:<br>Vraniq                                                                         | Nr. i parcelës<br>kadastrale:                          | GPS Koordinatat e objektit:                                             |                                                                    |
| Sipas certifikatës me<br>nr. të lëndes :<br>3092/2020, datë<br>20.08.2020, Zona<br>Kadastrale- Vraniq | 00014-0                                                | Y= 7491028.902;<br>Y= 7491043.75;<br>Y= 7491046.586;<br>Y= 7491031.737; | X= 4688156.7<br>X= 4688158.826<br>X= 4688139.028<br>X= 4688136.902 |

|                                                        |                                                                                 |                        |                                                                            |
|--------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------|------------------------|----------------------------------------------------------------------------|
| <b>Lloji i ndërtimit të propozuar:</b>                 |                                                                                 |                        |                                                                            |
| Depo për ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve |                                                                                 |                        |                                                                            |
| <b>Kategoria e ndërtimeve të propozuara:</b>           |                                                                                 |                        |                                                                            |
| Kategoria I                                            |                                                                                 |                        |                                                                            |
| <b>Gabariti</b>                                        | 15.0 m' x 20.0m'                                                                | <b>Katshmëria:</b>     | <b>(P+0)</b>                                                               |
| <b>Vija rregullative</b>                               | Kufiri i parcelës gjegjëse me vijen rregulluese të rrugës për kyqje; min 9.8 m' | <b>Vija ndërtimore</b> | Sipas Aktvendimit mbi Kushte Ndërtimore: 07Nr.318/350-36137; dt.25.08.2020 |

### P ë r s h k r i m i

Me këtë vendim, poseduesit të lejës ndërtimore **Agro-Rural Consultancy Group ShPK** me përfaqësues **Bexhet Basha** nga **Vraniqi** i lejohe ndërtimi i objektit depo me etazhitet P+0.

Lokacioni i objektit është në kuadër të PZHK-së, 01Nr.5821 datë 05.03.2008, ku sipas gjendjes së planifikuar, në parcelën kadastrale 00014-0, është tokë ndërtimore me destinim **bujqësi**.

Objekti ka karakter të përkohshëm me katëshmëri (P+0). Ndërtimi i objektit të bëhet konform Kushteve Ndërtimore të lëshuara nga ky organ: 07Nr.318-350-36137, datë: 25.08.2020.

Objekti është lejuar të ndërtohet me gabarit: 20.0 m' x 15.00m' (sipas kushteve të lartcekura).

Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

#### Poseduesi i Lejës Ndërtimore është i obliguar që:

- Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.
- Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme:
  - Informata mbi Lejën Ndërtimore;
  - Informata mbi Projektuesin;
  - Informata mbi Kontraktuesin;
  - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
- Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
  - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
  - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit;
  - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
  - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit;
  - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
  - Librin dhe ditarine ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të

problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur;

- Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit
- Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore.
- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejës Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rastet kur:
  - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
  - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
  - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
- Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njejtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

## A r s y e t i m

Aplikuesi **Agro-Rural Consultancy Group ShPK** me përfaqësues **Bexhet Basha**, përmes kërkesës 07Nr.350/350-40862, të datës: 01.09.2020, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtim të objektit depo për ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendimi mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.318/350-36137, datë: 25.08.2020 (kopje),
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.121/20, datës: 27.07.2020, lëshuar nga NPRM “ECO-REGJIONI”- Prizren, Njësia operative Suharekë,
- Dëshmi për pagesën e taksës sipas njoftimit 07Nr.337/350-40862, datë: 04.09.2020, në shumë prej: **720.00€**, e paguar në VLLESA PAGESA Suharekë datë: 04.09.2020, sipas faturës komunale nr.0000577, datë: 04.09.2020,
- Vlerësim për kyqje në rrjetin publik të Ujësjetllësit dhe Kanalizimit – Hidroregjioni Jugor Prizren datë: 27.07.2020,
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor – nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09 Nr.595, datë: 19.08.2020,
- Pëlqim për rregullim të dokumentacionit teknik, KEDS-SH.A, Nr.1019, datë: 27.08.2020,
- Pëlqim për mbrojtje nga Zjarri Nr.03/03-82 datë 31.08.2020, lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjencë, Sektori i parandalimit të zjarrit,

- Pëlqim sanitaro-higjenik nga Inspektori i sanitarisë 09Nr.596 datë 19.08.2020,
- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike,
- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë,
- Vërtetimin e tatimit në Pronë,
- Kopje e dokumentit Identifikues.

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, konform PZHK-së 01Nr.5821 datë 05.03.2008, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

**Udhëzim juridik:** Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MEA në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

*Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Komuna Suharekë*  
*Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.341/350-40862 datë: 08.09.2020*

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Inspektoratit të Komunës;
- Dosjes së DUP-së

Drejtori i Drejtorisë:  
**Sanie KUQI**

